



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO**  
**KOMUNA E GJAKOVËS**  
**OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA**

GJAKOVA



**Njësia e Prokurimit**

Gjakovë, datë 21.05.2025

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.2) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 (paragrafi 63.1.3) të Rregullores për Prokurim Publik /Nr.001/2022 e plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren Nr. 002/2024, të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 19.05.2025, Operatori Ekonomik **JOOS & KRASNIQI - BAZE SH.P.K.**, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi rikonstruktimi i rrugës Kralan -Rakovinë”, Nr. i prokurimit- Nr. i prokurimit- 632-25-1362-5-1-1, Nr. i brendshëm-632-25-014-511, nxjerr:

**V E N D I M**

1. **Aprovohet si pjesërisht e bazuar** kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik “**JOOS & KRASNIQI - BAZE SH.P.K.**”, e dt.19.05.2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi rikonstruktimi i rrugës Kralan -Rakovinë”, Nr. i prokurimit- Nr. i prokurimit- 632-25-1362-5-1-1, Nr. i brendshëm-632-25-014-511, kundër DOSJES SË TENDERIT DHE NJOFTIMIT PËR KONTRATË, të publikuar me datë 28.02.2025, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.
2. **Korigjohet** DOSJA E TENDERIT DHE NJOFTIMI PËR KONTRATË, i publikuar me datë: 28.02.2025;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të bëjë korigjimin e Dosjes së tenderit dhe Njoftimit për kontratë .
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe publikohet në platformën elektronike të KRPP-së .

**A r s y e t i m**

Operatori Ekonomik “**JOOS & KRASNIQI - BAZE SH.P.K.**”, me dt.19.05.2025, ka parashtruar kërkesës për ri-shqyrtim , lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi rikonstruktimi i rrugës Kralan -Rakovinë”, Nr. i prokurimit- Nr. i prokurimit- 632-25-1362-5-1-1, Nr. i brendshëm-632-25-014-511.



Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 21.05.2025, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pika 3: Nuk aprovohet

Nuk është kërkuar në dosje të tenderit kërkesa siç pretendohet është kërkuar në nr. 27 - Sperkatese per bitumen dhe emulsion

Pika 4: Aprovohet pjesërisht

Pajisja nr. 2– NDRYSHOHET: Buldozer 20 t deri 26 t - sasia 1 copë

Pika 5: Nuk Aprovohet

Pajisjet nr. 3 – kanë kufizimi vetëm të maksimumit të peshës totale 11 t

Pika6: Aprovohet pjesërisht

Pajisja nr. 10– NDRYSHOHET: Cilindra me rrota te kombinuara (gome -hekur) me peshë max. 3t - sasia 1 copë

Pajisja nr. 11 – Hiqet nga lista e kërkesave

Pajisja nr. 12 - NDRYSHOHET: Cilindra me rrota te kombinuara (gome-hekur) me peshë minimum 8t deri 17t - sasia 3 copë

Pajisja nr. 13 - NDRYSHOHET: Cilinder me rrota hekuri me vibrim me peshe maksimale 5t - sasia 3 copë

Pika 7: Nuk Aprovohet

Tek stafi nuk janë kërkuar 20 punëtorë të certifikuar me SSHP por minimum një punëtor i certifikuar, ndërsa numri minimal prej 20 punëtorëve është kërkuar për shkak të vëllimit të punës që ka ky projekt. Udhëheqës i vend-punishtes është kërkuar inxhinier i ndërtimit me nivelin bachelor në profilin e hidroteknikës e që është niveli më i ulët i gradimit për inxhinier, ndërsa profili hidroteknik për veç që trajton ujërat ka të bëjë edhe me ndërtim të rrugëve, bënë pjesë tek ndërtimi i ulët.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si në dispozitiv.

**Këshilla juridike:**

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . **Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimiit te ketij vendimi.**

**Faton Gutaj**

**Menaxher i Zyrës së Prokurimit**

**Kopje:** Operatorit Ekonomik;  
Zyrës së Kryetarit te Komunës;  
Te gjitha palëve te interesuara.

